

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 05-11.05.2025

Janë testuar gjithsej 151 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=141) është shënuar një rritje prej 7,1%. Është regjistruar një rast pozitiv.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 05-11.05.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
05.5.2025	37	1	2,7%
06.5.2025	29	0	0,0%
07.5.2025	25	0	0,0%
08.5.2025	28	0	0,0%
09.5.2025	20	0	0,0%
10.5.2025	4	0	0,0%
11.5.2025	8	0	0,0%
Gjithsej	151	1	0,4%

Gjatë javës së kaluar (05-11.05.2025) janë regjistruar 2 persona të shëruar. Është raportuar një rast i vdekjes si pasojë e COVID – 19, me datë nga muaji prill. Personi ka ndërruar jetë në kushte spitalore, në moshë mbi 70 vjet, me komorbiditete, i vaksinuar me dy doza para katër vitesh.

GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 11.05.2025 janë regjistruar gjithsej 43 raste me COVID-19. Në muajin prill të vitit 2025 numri i të sëmurëve (n=9) është për 2 herë më i madh se në muajin mars 2025 (n=4).

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 2 raste të vdekjes si pasojë e COVID-19.

Gjatë vitit 2025, deri më 11.05.2025, janë testuar gjithsej 5.032 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Gjatë periudhës së kaluar po regjistrohet vazhdimisht një përqindje e ulët e rasteve pozitive. Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike.

Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i rasteve me COVID-19 në nivel javor është i ulët, duke pasur parasysh se ndodhemi në një periudhë të një qarkullimi të rritur të viruseve respiratore në hemisferën veriore, nevojitet një mbikëqyrje e vazhdueshme (epidemiologjike dhe virusologjike) në rrafsh lokal dhe kombëtar.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 11.05.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>